



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:266150
Datë: 21.01.2021
Numri i dokumentit: 01428892

A.nr.1010/19

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për çështje administrative, Divizioni Fiskal, me gjyqtarin Krenar Berisha, dhe me sekretaren juridike Nazife Sheholli, në konfliktin administrativ, të paditësit M.shpk me seli në L. kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike: vlerësim doganor, në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 21.01.2021, në prani të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHETKërkesëpadiae paditësit M.shpk me seli në L., si e pa bazuar.

Mbetet në fuqi Aktvendimi nr. 07.3/627 datës 25.03.2019 i Doganës së Kosovës në Prishtinë

A R S Y E T I M

Me aktvendimin kontestues e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë, në rivendosje, ka refuzuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimit nr.R-22368/16.06.2015 të Zyrës së Brendshme Doganore Prizren, si e pa bazuar.

Paditësi M. shpk me seli në L., me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 26.04.2018, ka inicuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar të aprovohet padia në tërësi si e bazuar, të anulohet aktvendimi nr. 07.3/627 datës 25.03.2019 i të paditurës i Doganës së Kosovës në Prishtinë, si dhe të obligohet Dogana e Kosovës që të bëjë kthimin e mjeteve të paguara më tepër në emër të detyrimeve të importit në vlerë prej 2489.40€.

Në padinë e tij dhe përmes përfaqësueses së autorizuar në seancën e shqyrtimit kryesor paditësi deklaroi: pranë ZBD Prizren kemi paraqit për zhdoganim mallin lëndor sipas dokumenteve përcjellëse të mallit. Me rastin e paraqitjes së mallit deklarates unike doganore i janë bashkangjitur të gjitha dokumentet përcjellëse të mallit të cilat kërkohen si dokumente që duhet të bashkangjiten deklarates doganore për vendosje të mallit në qarkullim të lirë në përputhje me nenin 123 të Udhëzimit Administrativ 11/2009. Përfaqësuesja e autorizuar e paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor deklaroi: e paditura e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimit kontestues, pas pranimit të Aktgjykimit A.nr.1440/2015. Sipas këtij Aktgjykimi e paditura e ka pasur për detyrë të deklarohet në lidhje me provat dhe pretendimet e paditësit, kështu që e ka obliguar që të veptoi sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetimin e

Aktgjykimit të gjykatës. E paditura nuk ka vepruar sipas vërejtjeve të gjykatës, dhe përsëri e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën e paditësit, për rishqyrtimin e vendimit kontestues. Gjykata ka konstatuar në këtë rast se aplikimi i metodës së 3 të vlerësimit të mallit bie në ndesh me nenet 33,35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, dhe për këtë vlerësim duhet të jepen arsye dhe prova dhe meqenëse për gjykatën ka qenë e pa mundur të vendos në lidhje me këtë çështje për shkak të të metave të konstatuara të vendimit kontestues e ka kthyer përsëri lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje dhe në këtë mënyrë e ka obliguar të paditurën që të deklarohej në lidhje me provat e prezantuara nga paditësi. Por e paditura nuk i ka marrë parasysh konstatimet e gjykatës, dhe ka vendosur përsëri ta refuzoi të pa bazuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimit kontestues. Paditësi ka mbështetur pretendimin e tij se ka paraqitur vlerën reale të mallit me anë të provave të cilat edhe Gjykata Themelore i ka vlerësuar kur ka vendosur në lidhje me këtë çështje, kështu që e paditura në mënyrë krejt të pa arsyeshme ka lëshuar një vendim jo të bazuar në ligj. Kërkoi nga gjykata që padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovoi si të bazuar dhe të anuloi vendimin kontestues duke detyruar të paditurën që paditësit t'ia kthej mjetet monetare të paguara më tepër gjatë procedurës së zhdoganimit.

E paditura në përgjigje në padi të datës 11.09.2020 dhe përmes të autorizuarit në seancën publike deklaroi: se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Vendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. Me aktvendimin e kontestuar të Doganës së Kosovës, është refuzuar ankesa e paditësit si e pa bazuar, aktvendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi, dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore, nuk qëndron me arsyetimin se vendimi i atakuar është marrë konform legjislacionit në fuqi, në mënyrë të drejtë. Dogana e Kosovës në rivendosje të lëndës ka konstatuar se ZBD në Prizren ka vepruar drejtë kur ka kontestuar vlerën e mallit dhe në të ka bërë rivlerësim duke përdorë metodën 3 të rivlerësimit. Dogana e Kosovës gjatë analizimit të çështjes kontestuese ka hulumtuar në sistemin “Cognos dhe Asycuda” importe të subjektit në procedurë dhe subjekteve tjera të cilat kanë importuar mallin e ngjashëm, për mallin e ngjashëm me mallin lëndor kontestues në periudhën e afërt kohore dhe ka konstatuar që baza e kësaj rritje është prova me importe të ngjashme me periudhën e afërt kohore, shih deklaratat e vendimit kontestues. I propozojmë gjykatës që padia dhe kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës; 21.01.2021, ka administruar provat relevante dhe atë: përgjigja në padi e dt.11.09.2020 nga Dogana e Kosovës, Aktvendimi nr.07.3/627 i dt.25.03.2019 i Doganës së Kosovës, Aktgjykimi A.nr.1440/15 i dt.04.02.2019 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Evidenca e mallit sipas Deklarimit dhe sipas Rivlerësimit “Kofsha Pule”, Deklaratat Doganore, Urdhër për pagesë ndërkombëtare e dt.11.06.2015 ProCredit Bank, Pro Forma e dt.01.04.2015, Konfirmimi i çmimit shitës të mallit nga eksportuesi-prodhuesi dhe komunikimet elektronike të eksportuesit me Doganën, Kundërshtimi në Bazë Doganore, i dt.16.06.2015, Procesi mbi përcaktimin e vlerës së mallrave i dt.16.06.2015, Deklarata e të dhënave në lidhje me vlerën doganore, Marrëveshja e Transportit.

Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81G të Ligjit nr.04/L-102, në seancën e mbajtur me datë 21.01.2021, vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, dhe konstatoi se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Nga arsyetimi i vendimit kontestues gjykata konstaton se e paditura në rivendosje, ka konfirmuar rivlerësimin e ZBD Prizren, për mallin lëndor të zhdoganuar me DUD-in kontestuese, duke konstatuar se ka aplikuar drejt metodën e 3 të vlerësimit nenin 34 paragrafi 2 pika (b) të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, ku si provë janë marrë të dhënat sipas vlerës së transaksioneve të mallrave të ngjashme, R13821/15.06.2015, R13822/16.06.2015, R13825/16.06.2015.

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja te cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se as në këtë konflikt administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t'ia dëshmoj provat për të vërtetuar se vlera e mallit lëndor është vlera e vërtet e transaksionit e paguar për mallrat e shitura për eksport ne Kosove, siç parashihet me dispozitat e nenit 33 te Kodit Doganor dhe te Akcizave nr. 03/L-109.

Për të pranuar vlerën e paguar të transaksionit sipas metodës së parë të vlerësimit nga neni 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave te Kosovës 03/L-109, dhe për tu pranuar dokumentacioni i harmonizuar në kuptim të nenit 123 të Udhëzimit Administrativ nr.11/2009 për implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave, në këtë rast paditësi është dashur të dëshmoj vlerën e vërtet të transaksionit të cilën ia ka paguar shitësit-eksportuesit të mallit lëndor. Edhe pse pala paditëse i ka prezantuar të paditurës dhe gjykatës provat materiale si faturën e mallit doganor nr.91870/19.05.2015, profaturën, marrëveshjen për transport, mirëpo transaksioni bankar i datës 11.06.2015 Pro Credit Bank, në shumën prej 53,549.28USD, nuk harmonizohet me vlerën faturale të deklaruar sipas DUD-it R22368/16.06.2015, në shumën prej 50,202.45USD, fakte këto të cilat paditësi nuk i ka sqaruar arsyet e mos harmonizimit të dokumentacionit të mallit doganor.

Prandaj gjykata konstaton se paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës ti provoj me argumente të bazuara pretendimet se ka paraqitur dokumentacionin e duhur sipas të cilit do të duhej që e paditura Dogana e Kosovës ta vlerësonte mallin sipas metodës së parë të vlerësimit neni 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109.

Si fakte vendimtare që kane ndikuar në rivlerësimin e mallit lëndor sipas nenit 35 të Kodit Doganor dhe te Akcizave te Kosovës, ka qenë se e paditura Dogana e Kosovës posedon të dhëna sipas vlerës së transaksioneve të mallrave të ngjashme nga shteti i njëjtë shtet eksportues, në periudhë të afërt kohore, të cilat mallra kanë vlerë më të lartë se vlera e deklaruar nga paditësi. Gjykata vlerëson se provat e tilla me të cilat është rivlerësuar malli lëndor sipas transaksioneve të mallrave të ngjashme DUD-i R13821/15.06.2015, R13822/16.06.2015, R13825/16.06.2015, është provë e bazuar për tu vlerësuar malli lëndor sipas nenit 35 të Kodit Doganor dhe te Akcizave te Kosovës 03/L-109, prandaj gjykata konstaton se është aplikuar drejt dispozita ligjore kur është rivlerësuar malli lëndor.

Gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja qe e ka konstatuar e paditura ne procedurën administrative, për arsye se nga pretendimet e fakteve të paraqitura në procedurën e konfliktit administrativ, nuk janë paraqitur provat e mjaftueshme që do të dëshmonin vlerën e transaksionit të mallit lëndor.

Në bazë të gjendjes faktike, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, gjykata konstaton se aktvendimi nr.07.3/627 i datës 25.03.2019i Doganës së Kosovës në Prishtinë, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar ne dispozitat ligjore ne fuqi.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81.I par.2 pika 2.1 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTINE
Departamenti për çështje administrative-Divizioni Fiskal
A.nr.1010/19 datë 21.01.2021

G j y q t a r i,
Krenar Berisha

KESHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 60 ditësh nga marrja e të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.